

Informacion mbi vendimin e Këshillit Kombëtar të SPMSH për thirrjen e Kongresit të Vltë të SPMSH në 7-8 Shtator 2012.

Në bazë të dispozitës së Statutit të SPMSH , neni 21 më datë 15 .10.2011 në qytetin e Elbasanit u mbajt Këshilli Kombëtar i SPMSH nën drejtimin e Presidentit të saj z. Gëzim Kalaja .

Mbledhja mbasi diskutoi rreth problemit të realizimit të objektivave përcaktuar nga Kongresi i Vtë dhe detyrave për të ardhmen përfundimisht me vota unanime

vendosi:

1. Të thirret Kongresi i Vltë i radhës së SPMSH brenda datës 7-8 Shtator 2012 në qytetin e Elbasanit .

2. Të hartojë rregullat dhe procedurat e fushatës zgjedhore nga Kryesia e Përgjithshme e SPMSH të cilat do t'i paraqiten për miratim mbledhjes së ardhshme të Këshillit Kombëtar të SPMSH i cili do të mbahet në fillim të muajit Maj 2012 .

3. Në bazë të Nenit 21 të Statutit të SPMSH kryesia e përgjithshme e sindiktaës të përcaktojë numrin e përgjithshëm të delegatëve për kongresin e Vltë sipas kriterëve të përfaqësimit të cilat do të paraqiten për miratim në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Kombëtar që do të zhvillohet në fillim të muajit Maj.

4. Këshilli Kombëtar vendosi që krahas kandidaturave të tjera që mund të dalin për kandidat për President të SPMSH gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore nga rajonet dhe konferencat zgjedhore të pranojë propozimin e Kryesisë së Përgjithshme të SPMSH për kandidat për President z. Gëzim Kalaja , i cili do të paraqitet për miratim në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Kombëtar të SPMSH .